

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“FRONTERA MEDICAL & SPA”

Sot, më datë 08/01/2025, në mbështetje në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqërítë Tregtare” dhe Ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, Ortaku i Vetëm i gjeneralizuar më poshtë:

- Znj. Dorina Shamo, atësia Haki, lindur në Krujë më datë 08/07/1983, pasaportë numër BF2055583, numër personal I35708010U;

me vullnet të lirë dhe të plotë, themelon shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “Frontera Medical & SPA” si në vijim:

KREU I

*Emërtimi, Forma Juridike, Zyra Qendrore, Objekti i Veprimitarise, Kohëzgjatja,
Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit, Përgjegjësia e Ortakut të Vetëm*

Neni 1
Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “Frontera Medical & SPA”.

Ndryshimi i emërtimit të shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë të Përgjithshme (Ortakut të Vetëm).

Neni 2
Forma Juridike

Shoqëria tregtare “Frontera Medical & SPA” ka formën juridike e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

Neni 3
Zyra Qendrore

Zyra qendrore (selia) e Shoqërisë “Frontera Medical & SPA” sh.p.k. ndodhet në Tiranë, Rruga “Abdyl Frashëri”, Pallati Nr.7, Apartamenti Nr. 1.

Zyra qendrore (selia) e Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë të Përgjithshme (Ortakut të Vetëm).

Neni 4
Objekti i Veprimitarise

Shoqëria “Frontera Medical & SPA” sh.p.k. do të ushtrojë veprimitarinë e saj tregtare si në vijim: Qendër estetike dhe parukeri. Të zhvillojë kurse të formimit profesional përmbarëvajtjen dhe specializimin e punonjësve nga ana estetike, profesionale, teknike etj., si dhe kurse të formimit profesional në fushën e estetikës. Parukeri, make-up, hair style, manikyr dhe pedikyr. SPA dhe shërbime ndërlidhëse.



Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria “Frontera Medical & SPA” sh.p.k. do të ushtrojë veprimtarinë e saj për një afat kohorë të pakufizuar.

Neni 6
Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare “Frontera Medical & SPA” sh.p.k. mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me vendim të Asamblesë të Përgjithshme (Ortakut të Vetëm).

Neni 7
Përgjegjësia e Ortakut të Vetëm

Ortaku i Vetëm nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë “Frontera Medical & SPA” sh.p.k. dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tij.

KREU II
Kapitali i Shoqërisë dhe Kuotat, Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit, Kalimi i Kuotave të Kapitalit

Neni 8
Kapitali i Shoqërisë dhe Kuotat

Kapitali i shoqërisë “Frontera Medical & SPA” sh.p.k. është 500000 (Peseqind mijë)

Ortaku i Vetëm i shoqërisë, Znj. Dorina Shamo, atësia Haki, lindur në Krujë më datë 08/07/1983, pasaportë numër BF2055583, numër personal I35708010U, zoteron 1 (një) kuotë me vlerë 500000 (Peseqind mijë) lekë e cila përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

Kapitali i shoqërisë prej 500000 (Peseqind mijë) lekë është shlyer tërësisht nga Ortaku i Vetëm.

Neni 9
Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit të Shoqërisë


Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblesë të Përgjithshme (Ortakut të Vetëm), në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjithsesi, kapitali i regjistruar i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e kërkuar nga ligji.

Neni 10
Kalimi i Kuotave të Kapitalit

Kuotat e kapitalit janë lirisht e transferueshme.

Kalimi i Kuotave të kapitalit të shoqërisë realizohet nëpërmjet:



- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shitblerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga ligji.

KREU III
Organet e Shoqërisë

Neni 11

*Asamblea e Përgjithshme
(Ortaku i Vetëm)*

Organi vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm).

Neni 12

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme (Ortakut të Vetëm)

Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm) është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- ndryshimet e statutit;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
- emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të regjistruar;
- përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të regjistruar;
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin dhe anulimin e kuotave;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- riorganizimin dhe/ose prishjen e shoqërisë;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- përcaktimin e pagave të punonjësve dhe dhënien e shpërblimeve përkatëse;
- të gjitha çështjet e tjera të cilat parashikohen nga ligji apo ky statut.

Neni 13

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme (Ortaku të Vetëm)

Asambleja e Përgjithshme (Ortakut të Vetëm) mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligji dhe nga ky statut.

Asamblesë së Përgjithshme (Ortakut të Vetëm) thirret të paktën një herë në vit.



Vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm), së bashku me procesverbalin e mbledhjes dhe aktet e tjera eventuale, regjistrohen në librin e shoqërisë.

Neni 14
Administratori

Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë.

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme (Ortakut të Vetëm).

Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit është 5 (pesë) vjet, me të drejtë ri-emërimi.

Administratori është përgjegjës për:

- a) administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme (ortakut të vetëm);
- b) përfaqësimin e shoqërisë tregtare;
- c) hartimin dhe nënshkrimin e çdo dokument të nevojshëm lidhur me mbarëvajtjen e aktivitetit të shoqërisë, si dhe t'i depozitojë pranë çdo organi kompetent shtetëror, apo personave të tretë privatë, në përpunim me legjislacionin shqiptar në fuqi;
- d) mbarëvajtjen e punëve të përditshme të shoqërisë, duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me mbikëqyrjen e personelit, punësimin dhe pushimet nga puna të personelit, dhënen e udhëzimeve lidhur me mënyrën e menaxhimit të punëve në shoqëri si dhe mbajtjen e korrespondencës së shoqërisë;
- e) blerjen, marrjen me qira etj. të mallrave apo shërbimeve të cilat lidhen në mënyrë direkte apo të tërthortë me punën e përditshme të shoqërisë;
- f) kryerjen e transferimeve bankare apo tërheqjen e shumave të nevojshme nga llogaritë e shoqërisë lidhur me pagat apo shpërblimet e punonjësve të shoqërisë, pagesën e detyrimeve fiskale ndaj organeve shtetërore, duke përfshirë të gjithë llojet e taksave, tatimeve, tarifave apo detyrimeve të tjera ndaj çdo organi shtetëror;
- g) kryerjen e të gjitha veprimet e tjera të nevojshme dhe të nënshkruajë çdo dokument për kryerjen e pagesave bankare, depozitime, tërheqje, derdhje, si dhe transferime apo lëvizje të çdo lloji në llogaritë bankare të shoqërisë me qëllim pagimin e detyrimeve të përshkruara në pikat e) dhe f) më sipër.

Administratori i Shoqërisë është Znj. Dorina Shamo, atësia Haki, lindur në Krujë më datë 08/07/1983, pasaportë numër BF2055583, numër personal I35708010U.

Neni 15
Dispozita përfundimtare

Ky Akt themelimi përpilohet në 4 (katër) ekzemplarë me përbajtje dhe vlera të njëjtë juridike në gjuhën shqipe dhe gjuhën italiane; Në rast divergjencë interpretimi, versioni i statutit i hartuar në gjuhen shqipe mbizotëron.

ORTAKU I VETEM THEMELUES I SHOQËRISË
Znj. Dorina Shamo

Dorina Shamo
D.S.